



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINË *MUNICIPALITY ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINE PRISHTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40, të Ligjit mbi tokën ndërtimore ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 14/80 dhe 42/86), të nenit 3, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2003 merr:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR ANEKSENDËRTIMIN E OBJEKTIT TË ÇERDHES SË FËMIJËVE "GËZIMI YNË" NË LAGJEN "ULPIANA" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për aneksendërtimin e objektit të çerdhës së fëmijëve "Gëzimi Ynë" në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë.

Lokacioni, nga alinea 1. e këtij neni, është pjesë e ngastrës kadastrale nr. 7429/1 dhe 7429/2, Komuna kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe prej 15,00 ari, pronë e Komunës.

Neni 2

Lokacioni, nga neni 1 i këtij Vendimi i bashkangjitet kompleksit ekzistues të qerdhës së fëmijëve "Gëzimi Ynë" në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë.

Neni 3

Rregullimin urbanistik të bazës së tokës ndërtimore, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, ndërsa Drejtorati i Kadastrit, Gjeodezisë dhe Çështjeve Pronësores -Juridike do të kryejë veprime procedurale nga përgjegjësia e tij për definimin dhe inçizimin e lokacionit sipas këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi, nga aspekti i realizimit të lokacionit do të kujdeset Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, ndërsa, nga aspekti i realizimit të objektit, Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës, të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Pjesë përbërëse të këtij Vendimi janë: pjesa tekstuale dhe grafike e situacionit të lokacionit nga neni 1, i këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 353-2083 DT. 03.12.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri